



KOMUNA  
**RAHOVEC**

Qershori 2025

## PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse .....	2
Zotimet.....	3
Prioritetet e programit qeverisës.....	3
Prioritetet për vitin 2025.....	4
Synimet për vitin 2025 .....	5
Sfidat kryesore për vitin 2025.....	6
<b>Zyra Ligjore.....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit.....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra e Prokurimit.....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra për Informim dhe Marrëdhëniet me Publikun .....</b>	<b>8</b>
<b>Zyra e Auditimit të Brendshëm.....</b>	<b>8</b>
<b>Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim .....</b>	<b>8</b>
<b>Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura.....</b>	<b>9</b>
<b>Drejtoria për Administratë .....</b>	<b>12</b>
<b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet .....</b>	<b>14</b>
<b>Drejtoria për Arsim .....</b>	<b>16</b>
<b>Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....</b>	<b>16</b>
<b>Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm .....</b>	<b>17</b>
<b>Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit .....</b>	<b>18</b>
<b>Drejtoria për Shërbime Publike.....</b>	<b>19</b>
<b>Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural .....</b>	<b>20</b>
<b>Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë .....</b>	<b>20</b>
<b>Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .....</b>	<b>21</b>
<b>Drejtoria për Punë Inspektuese .....</b>	<b>21</b>
<b>Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.....</b>	<b>23</b>
<b>PËRFUNDIM .....</b>	<b>24</b>

## KRYETARI I KOMUNËS

### Fjala hyrëse

*Qytetarë të komunës së Rahovecit,*

*Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të komunës dhe Qeverisë komunale 2025, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmujor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2025.*

*Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtive komunale në komunën e Rahovecit, si dhe të njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.*

*Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvisojojë progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.*

*Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë komunale. Raporti gjashtëmujor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, i përkushtimit, i angazhimit dhe i vendosmërisë së treguar në përm bushjen e detyrave dhe të obligimeve, me qëllim të rritjes së mirëgenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.*

## Zotimet

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standarde të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve, si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

## Prioritetet e programit qeverisës

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë, si dhe rritja e përkrahjes për këta sektore;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

## Prioritetet për vitin 2025

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Ndërtimi i Ballkonit panoramik;
- Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të hapësirave publike;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim të vlerave kombëtare historike dhe të luftës çlirimtare (komplekset përkujtimore, muzetë, monumentet e trashëgimisë kulturore historike, lapidarët, varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve etj.);
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Përmirësim i infrastrukturës së institucioneve shkolllore
- Bursa për studentë;
- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe në krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinetë;
- Përkrahje e fermerëve me serra, me inpute bujqësore dhe me farëra;
- Rrugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinare periodike falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujqë dhe biznese;
- Ndërtimi i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me K.R.U. “Gjakova” dhe me donatorë të tjera për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficiencia e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të EE-së dhe të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i mëtejshëm i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Mqedise të bucura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e numrit dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional;
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinasë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturo-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturo-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;

- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkratje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrrenjve;
- HZK - do të miratohet Harta Zonale e Komunës, pas shqyrtimit publik;
- Plotësim-ndryshimi i rregullores së Komunës së Rahovecit;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të rejat;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

### Synimet për vitin 2025

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhit të tokave bujqësore;
- Në bashkëpunim me donatorët do të angazhohemi për zgjerimin e sistemit të ujites në pjesët ku mungon;
- Përfundimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Funksionimi i repartit të hemodializës;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Funksionalizimi i lokaleve afariste te stacioni i autobusëve;
- Funksionalizimi i qendrës së magazinimit – depos bujqësore;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspekture, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;

- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe i lirimit të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerra e akteve dhe e rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore, si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendorë e ndërkombëtarë, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

### Sfidat kryesore për vitin 2025

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

### Zyra Ligjore

Vendime për Kryetarin e Komunës	210
Vendime për Kuvendin e Komunës	46
Urdhëresa	45
Rregullore	1
Kontrata	14
Autorizime	7
Akte përcjellëse	6
Marrëveshje	4
Propozime për Kuvend	21
Opinion ligjor	1
Konsultime	permanente
Kërkesa	1
Përgjigje në kërkesa	6
Njoftime	2
Vendime për Drejtori	13
Punë në komisione	13
<b>Totali:</b>	<b>390</b>

### Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Janë shpallur gjithsej 29 konkurse publike, prej të cilave: 12 në Shërbimin Civil; 14 në Drejtorinë për Arsim; 3 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Njësia e Personelit ka hartuar gjithsej 160 shkresa administrative, përfshirë: kontrata, vërtetime, vendime, projekt-vendime, propozime, aktemërime, informacione, njoftime, kërkesa dhe raporte të ndryshme.

Kjo njësi merret edhe me vlerësimin e punës provuese; përcjelljen e vijueshmërisë në punë; planin e trajnimeve për nëpunësit civilë; menaxhimin e burimeve njerëzore përmes HRMIS-së etj.

### Zyra e Prokurimit

Janë proceduar: 42 aktivitete të prokurimit në vlerën 16.577.019.16 euro; Janë nënshkruar 21 kontrata të gjitha prokurimeve: punë, Furnizime, Shërbime në vlerën 9.147.050.33 euro;

Pesë aktivitete të prokurimit janë me ankesë në organin shqyrties të prokurimit;

Tri (3) aktivitete të prokurimit janë anuluar;

13 aktivitete të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit; Personeli i zyrës së prokurimit ka proceduar 464 urdhër-blerje, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale, mallra dhe shërbime.

## Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë muajve janar- qershori 2025 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

Lajme	Njofime	Dok. financiare	Thirje	Konkurse	Plane	Takime/Dëgjime Konsultime	Raporte	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej:
120	40	12	5	10	3	6	5	4	210	<b>508</b>

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i Komunës, janë dërguar te zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në faqen ueb zyrtare të Komunës.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve si nga ministritë edhe nga OJQ-të e që kanë pasur të bënин me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.

## LEKTORIMI

Zyrtarja për lekturim ka redaktuar dokumente kryesisht me kërkesë të Kryetarit të Komunës, dokumente nga Njësia e Personelit, nga drejtoritë dhe nga Kuvendi. Për periudhën gjashtëmujore 2025, janë redaktuar rreth 500 dokumente, nga to: vendime, propozime, urdhëresa, raporte, kërkesa, informata, procesverbale etj.

*Zyrtarja për lekturim merret edhe me përpilimin dhe përgatitjen për publikim të gazetës zyrtare të Rahovecit, në baza mujore.*

## Zyra e Auditimit të Brendshëm

### Drejtoritë e audituara:

1. Auditimi i brendshëm në Zyrën e Prokurimit;
2. Auditimi i performancës - subvencionet në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Auditimi i brendshëm në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm (në proces).

## Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Janë iniciuar projekte infrastrukturore në vendet në të cilat banojnë komunitete joshumicë; Është themeluar Kolegjumi i 24-të për Komunitete dhe Kthim, në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Ka trajtuar dhe procesuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave për riatthesim dhe mbështetje për të kthyerit, duke ndihmuar integrimin e tyre të qëndrueshëm.

**Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura**

**Registrat:**

1. Registri për lëndë (procedurë) civile "C";
2. Registri për lëndë (procedurë) civile përmbarimore "CP";
3. Registri për lëndë (procedurë) konfliktet administrative "KA";
4. Registri për lëndë (procedurë) të ndryshme "CN";
5. Registri për lëndë (procedurë) at-hezionit "PA" dhe
6. Registri për lëndë (procedurë) ekonomike-komerciale "EK".

<b>PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE</b>								
	Sipas regjistrave të ZPL-së	Civile	Përbartimore	Konflikt administrativ	CN Ndryshme	Proc.At_hezionit	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
<b>1</b>	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	1084	1617	13	35	17	11	2777
<b>2</b>	Lëndë të pranuara	249	751	4	0	0	0	1004
<b>3</b>	Të gjitha lëndët në punë	1333	2368	17	35	17	11	3781
<b>4</b>	Lëndë të zgjidhura	247	655	1	0	0	0	903
<b>5</b>	Lëndë të mbeturë	1086	1713	16	35	17	11	<b>2878</b>

**1. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2025:**

<b>PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE</b>								
	Lëndë të reja të pranuara gjatë periudhës raportuese	Civile	Përbartimore	Konflikte administrative	Civile Ndryshme	Proc.At_hezioni	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara
1	Vërtetim i pronësisë	2	0					2
2	Kompensimet sipas kontratës kolektive	46	744					<b>790</b>

3	Konteste pune	0						0
4	Lëndë të tjera	201	7	4	0	0	0	212
5	Komuna paditësc/kreditore	0	0	1	0	0	1	2
	Gjithsej:	249	751	5	0	0	1	1006

**2. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE**

PARASHTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMO RE	KONFLIKTE ADMINISTRAT	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Komercale Ekonomike	GJITHSEJ
Aktvendim+Aktgjykim I	652	13	7	0	0	0	672
Aktvendim+Aktgjykim II	51	0	5	0			56
Aktvendim+Aktgjykim III	2		0	0			2
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	2						2
Urdhër përbarimor		1303					1303
Aktvendim E për lejimin e përbarimit		0					0
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	249		4	0			253
Aktvendim për përgjigje në padi	249		4	0	0		253
Përgjigje në ankesë C	2		0	0			2
Përgjigje në ankesë P							0
Përgjigje në prapësim		3					3
Përgjigje në revizion	0						0
Përgjigje në propozim për ML	0						0
Precizimi i padisë	13		0				13
Prapësim i debitorit		4					4
Ankesë C e paditësit	215						215
Ankesë P e kreditorit		2					2
Revizion C i paditësit	0			0			0
Ekspertizat	5	48		0			53
Aktakuzë					0		0
Parashtresat c tjera	101	0		0			101
	1541	1373	20	0	0	0	2934

<b>PARASHTRESA TË DËRGUARA</b>		<b>CIVILE</b>	<b>PËRMBARI MORE</b>	<b>KONFLIKTE ADMINISTR</b>	<b>CIVILE NDRYSHME</b>	<b>P_Athezionit</b>	<b>Departamenti Ekonomik</b>	<b>GJITHSEJ</b>
Ankesat	12	1	0	0	0	0	0	13
Përgjigje në ankesë	0		0	0				0
Përgjigje në padi	249		4	0		0	0	253
Mbrojtje në padi DHP GJS	0							0
Revizion	0							0
Përgjigje në revizion	0		0					0
Propozim për ML	0		0					0
Përgjigje në ML	0							0
Prapësimë		5						5
Përgjigje në prapësim		0						0
Ushtrimi i kundërpërmbarimit		1						1
Ushtrimi i padisë	0		1				1	2
Kundërpadi	0							0
Kallëzim Penal					0			0
Ushtrimi i propoz. për përbartim	0	0						0
Parashtresat e tjera	1	1	0	0	0	0	0	2
Gjithsej:	262	8	5	0	0	1	0	276

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

<b>Seancat gjyqësore gjatë vitit 2025</b>	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	gjithsej
Nr. i seancave të mbajtura:	10	10	17	11	13	2	0	0	0	0	0	0	63
<b>Sipas kontesteve - seanca të caktuara/mbajtura</b>													
<b>Civile</b>							56						
<b>Përbartimore</b>							0						
<b>Konflikte administrative</b>							4						
<b>Civile – të ndryshme</b>							3						
<b>Proc.Ath. hezionit</b>							0						
Gjithsej:							63						

## Drejtoria për Administratë

### Sektori i Gjendjes Civile

Certifikata të lindjes	10957
Deklarata e bashkësisë familjare	556
Statusi martesor	524
Certifikata të martesës	1858
Certifikata të shtetësisë	105
Certifikata të vendbanimit	1021
Certifikata të vdekjes	603
Vërtetime nga arkivi	389

Lindjet vendore	27
Lindjet e jashtme	138
Martesat vendore	206
Martesat e jashtme	35
Martesa me shtetësi të huaj	8
Vdekjet vendore	32
Vdekjet e jashtme	23
Aktvdekjet	145
Pranimi i atësisë	4
Aktvendim - korrigjimi i emrit personal	8
Aktvendim - regjistrimi i lindjes së mëvonshme	0
Aktvendim - Regjistrimi i vdekjes së mëvonshme	19
Aktvendim - ndërrimi i emrit personal	21
Aktvendim - anulimet e regjistimeve të dyfishuara	3
Aktvendim - riregjistrimi i lindjes	3

Të hyrat financiare në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme për periudhën janar – qershori 2025, janë 31,123.00 euro.

### Sektori për Punë të Kuvendit dhe të Komitetave

Mbledhje të rregullta të Kuvendit	5
Komiteti për Politikë dhe Financa	5
Komiteti për Komunitete	3
Mbledhjet e KKSB-së	2
Komiteti për Shëndetësi	2
Komiteti për Arsim	0

Komiteti për Auditim	1
Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara	3
Mbledhje të jashtëzakonshme	1
Mbledhje emergjente	0
Mbledhje solemne	0
Mbledhje përkujtimore	0

### Sektori për IT

Rikonfigurimi dhe inspektimi i kompjuterëve; monitorime të sistemeve; transmetime të mbledhjeve në faqen-ueb; mbikëqyrje e pajisjeve për printim, skanim, kopjim; përkujdesje për e-kiosket dhe one stop shop; krijime të llogarive etj.

### Qendra për Shërbime me Qytetarë

Drejtoria për Administratë	shenja e klasifikimit	nr. i kërkesave	të paguara	të liruara	gjithsej
Kërkesa/ankesa	320/04	4654	5508	530	5184
Mbajtës familjeje	040/01	677/10euro	677	//	6770
Vërtetime të ndryshme	320/04	357/2euro	357	//	714
Referanca	320/04	17/50 euro	17		850
Totali					13,518.00

### Sektori për Mirëmbajtje, Logistikë dhe Sigurim të objekteve

Rregullimi i çështjeve logistikë (pastrim, kujdes për gjelbërim etj.); mirëmbajtja e automjeteve zyrtare, servisimi, sigurimi, regjistrimi i tyre, furnizimi transparent me derivate etj.

### Sektori për të Drejtat e Njeriut

Është marrë me aktivitete dhe ka bashkëpunuar me organizata me qëllim vetëdijen kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve; mbikëqyrje e legjislativit vendor e ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Në këtë periudhë janë shqyrtuar tri kërkesa për persona të riatdhesuar.

### Sektori për Barazi Gjinore

Angazhim në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas ashtu siç parashihen me ligjet tona në fuqi

dhe me konventa ndërkomëtare. Bashkëpunime të ngushta me organizata komëtare e ndërkomëtare.

### **Drejtoria për Financa dhe Buxhet**

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 ndahet në dy fonde burimore:**

- Granti qeveritar ..... 18,981,085.00 €
- Të hyrat vetanake ..... 2,001,711.00 €  
gjithsej:..... 20,982,796.00 €

➤ **Buxheti final për vitin 2025 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

- Paga dhe Mëditje ..... 10,746,449.00 €
- Mallra dhe Shërbime ..... 2,811,100.03 €
- Shpenzime komunale ..... 390,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere ..... 1,060,000.00 €
- Investime kapitale ..... 6,721,007.46 €  
totali: 21,728,556.49 €

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto detyra:

- Zotime, pranime, shpenzime për mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe përgatitje të ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë;
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në faqen ueb të komunës së Rahovecit.

## BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim / buxheti final %	Shpenzim / alokim %
<b>Paga dhe Mëditje</b>	-	10,746,449.00	10,746,449.00	5,559,630.92	4,647,296.80	43.24%	83.59 %
<b>Mallra dhe Shërbime</b>	931	2,590,408.00	2,811,100.03	2,665,502.03	2,064,771.00	73.45%	77.46 %
<b>Shpenzime komunale</b>	240	390,000.00	390,000.00	390,000.00	204,195.21	52.36%	52.36 %
<b>Subvencione dhe Transfere</b>	87	1,010,000.00	1,060,000.00	445,087.87	443,548.04	41.84%	99.65 %
<b>Investime Kapitale</b>	89	5,254,228.00	6,721,007.46	6,234,672.88	4,858,325.80	72.29%	77.92 %
<b>Totali:</b>	<b>1347</b>	<b>18,981,085.00</b>	<b>21,728,556.49</b>	<b>15,294,893.70</b>	<b>12,218,136.85</b>	<b>56.23%</b>	<b>79.88 %</b>

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsyet e bartjes së mjeteve të mbeturë nga viti 2024 në kategorinë e investimeve kapitale, donacionet, granti performancës, alokimi i huamarrjes në Arsim dhe në Shëndetësi në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, rezervat.

### Paraqitura grafike



- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2025 janë 2,001,711.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 950,330.26 euro apo 47.48% të planifikimit vjetor.

### **Sektori i Tatimit në Pronë**

- Gjatë periudhës janar-qershori 2025, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumën prej 256,842.02 euro apo 45.26 % vjetor (planifikimi vjetor 567,464.00), ndërsa tatimi në tokë ka realizuar të hyra prej 276,611.09 euro apo 142,632.09, tejkalim të planit vjetor (planifikimi vjetor: 133,979.00).
- Regjistimet e reja janë: 204 objekte, ose 36,930 m<sup>2</sup>. Verifikimi i objekteve: 1918 ose 310,938 m<sup>2</sup>.

### **Drejtoria për Arsim**

- Plani i menaxhimit për kontratën e projektit “Digjitalizimi dhe audiovizualizimi i materialeve mësimore në ShFMU –të e komunës së Rahovecit;
- Furnizimet me pako pedagogjike për mësimdhënësit e të gjitha niveleve;
- Sesion informues për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të testit ndërkombëtar PISA; mbajtja e testit;
- Punime në ndërtimin e objektit të ShFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxe, si dhe të objektit të ShFMU “Milaim Krasniqi”; punime në riparimin e shkollës “Nesimi Elshani” dhe në shkollen “Katër dëshmorët”.
- Seson informues me mësues të programit fillor për fillimin e zbatimit të projektit “Digjitalizimi dhe vizualizimi i materialeve mësimore”;
- Ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë në objektin e ShFMU “Isa Boletini”, në IAAP “Selajdin Mullaabazi”, si dhe në ShFMU “Rilindja”;
- Dhënia e bursave për studentë dhe për nxënës.

### **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

- 296 vendime për ndihma momentale – financiare;
- Ofrimi i shërbimeve të përhershme mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc;
- Shërbimi mjekësor "Kujdesi shtëpiak". Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime mjekësore nga ora 7:00 deri në orën 21:00;
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit;
- Funksionon aparati i mamografisë, i cili vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovecit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes e dhe mirëqenies së saj;
- Janë mbështetur OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale;

- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrje-ftesat për vaksinimin e fëmijëve;
- Është bërë rinvimi i objektit të Handikos-it.

### **Ecuria e realizimit të projekteve kapitale**

- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunës; Vazhdon rinvimi i objekteve të QMF-ve; Është bërë përrurimi i objektit të QMF-së në Ratkoc; Vazhdon meremetimi i objektit të shoqatës “Hareja”.

#### **Mirëqenia Sociale:**

Komisionet kanë punuar vazhdimesh në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimesh në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj; janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare; është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë, kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

#### **Shërbimet në QKMF**

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej 61.816 shërbime, prej tyre:

- 21944 pacientë të trajtuar në Sektorin e Mjekësisë Familjare;
- 1385 pacientë në urologji;
- 1368 pacientë në stomatologji;
- 246 fotografime në ortopan;
- 5614 raste urgjente të trajtuara në sektorin e urgjencës;
- 2074 shërbime në laborator;
- 1257 shërbime në rtg cabinet;
- 31719 terapi intramuskulare;
- 125 mamografi;
- 1413 shërbime gjinekologje;
- 1986 vizita shtëpiake;
- 406 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç;
- 28 lindje.

### **Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**

#### **Sektori për Ekonomi**

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksa komunale	30.632.20€

#### **Sektori për Zhvillim**

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë	31.303.02€

### Zyra e QKRB-së

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	100
4	Informata të bizneseve	53
5	Shuarje të biznesit	9
6	N.U.I.	7
7	Lëndë të anuluara	4
8	Certifikata dublikate	4
9	Historiat biznesi	1
10	Ndryshime në biznes	23
11	Vërtetim individual	10
	Gjithsej lëndë të përfunduara	211

### Menaxhimi i aseteve komunale

1. Përgatitja e raportit në SIMFK dhe në E-pasuria;
2. Zhvlerësimi i aseteve mbi dhe nën 1.000 euro;
3. Shitia e aseteve të papërdorura nëpërmjet ritenderimit.

### Sektori i Turizmit

Projekti ReLOaD2;

-Bashkëpunim me bizneset artizanale dhe me përfaqësuesit e verarive dhe të bodrumeve në komunën e Rahovecit.

### Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

#### Sektori i Urbanizmit dhe i Planifikimit

Janë shqyrta:

janar – qershor 2025					
Kërkesat	Nr.	ap.	re.	sh.	hidhet
Leje ndërtimi	19	17		2	
Leje rrënimí	4	3		1	
Leje përdorimi	4	4			
Kushte ndërtimore	51	39	1	10	1
Legalizim	4	4			
Totali i të hyrave:			18,583.82 €		

### Sektori i Mjedisit

Në bazë të Sektorit të Mjedisit lëshojmë leje mjedisore komunale dhe leje ujore komunale:

	janar - qershor 2025			
Nr. total	aprovuar	refuzuar	në shqyrtim	hidhet
15	14		1	0
Të hyra:	<b>1,848.30 €</b>			

<b>Totali i të hyrave në DUPMM:</b>	<b>20,432.12 €</b>
-------------------------------------	--------------------

### Harta Zonale Komunale 2025-2033; Ndërtimi i Sheshit Qendoror në qytet; Ballkoni panoramik

Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit; Faza e parë e projektit: “Trajtimi i shtretërve të përrenjve” në komunën e Rahovecit; Ndërtimi i rrugës përgjatë sheshit qendoror; Punime në ndërtimin e kullës në Retijë; Punime në ndërtimin e rrugës në Krushë të Madhe.

### Drejtoria për Shërbime Publike

- Ndërtimi i pritoreve (16 pritore) dhe vendosja e shenjave;
- projekti i zgjerimit të kanalizimit;
- mirëmbajtja e rrugëve në zonat urbane, në përmirësimin e ujëmbledhësve dhe të gropave të krijuara në rrugë;
- zgjerimi i ndriçimit publik;
- projekti i gropave bioseptike sipas programit të EU-së, projekte nga IPA, janë në përfundim 6 gropë septicë;
- Po vazhdon projekti i rrugës 4-korsi, lot 1, në këtë periudhë ka përfunduar muri mbrojtës, janë në përfundim të dy lëshesave pllakore, si dhe gjërmimi i rrugës në gjatësi 1.4 km;
- mirëmbajtja e hapësirave publike, eliminimi i deponive ilegale, pastrimi i hapësirave publike; krasitja e drunjve dekorativë;
- ndërtimi i trotuareve në rrugën “Ibrahim Rugova” në Rahovec;
- rregullimi i një pjese të rrugës ndërmjet dy fshatrave Vrajakë dhe Bratatin, si dhe rrrethrrrotullimi;
- projekti i ndërtimit të rrugës në Krushë të Madhe - “Ruga e Drinit”,
- Vazhdojnë punimet në segmentin rrugor “Sapniq-Nashpall-Vrajak” - hapja e trasesë, mbushja, ndërtimi i urës;
- Punime në fshatin Sapniq në ndërtim të përroit;
- Është nënshkruar memorandumi për mbështetjen e projektit të rrugës Fortesë-Sapniq me vlerë 650,000.00 euro;
- ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Malësi e Vogël, e gjatë 1200 metra.

## **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, janë sektorët kryesorë, të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Përmes politikave dhe strategjive, tentojmë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas të resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

### **Disa nga aktivitetet më kryesore në këtë gjashtëmuaj:**

Memorandum bashkëpunimi me organizatën “Chatar charity” për ndërtimin e 50 serrave **96 m<sup>2</sup>**; janë përkrahur 31 familje me serra;

Kanë aplikuar **81** blegtori, 74 prej tyre kanë aplikuar me **1,814,352** litra qumësht, 13 prej tyre me **204** viça.

Thirrje për aplikim për fermerë vreshtarë “Përkrahja e fermerëve vreshtarë me preparate për luftimin e insektit ‘CIKADIA’ e hardhisë së rrushit”.

Thirrje për përkrahjen e bletarëve me ushqim për bletë, kanë aplikuar 50 bletarë me gjithsej 3.829 koshere

Është publikuar lista e përfitueseve për sektorin e vreshtarisë për projektet të cilët janë hartuar nga konsulenca e angazhuar nga komuna, ku nga 18 aplikacione 15 prej tyre janë përfitues në skemën e granteve.

Është hapur thirrja për aplikim për kompanitë që bëjnë grumbullimin dhe përpunimin e perimeve  
është hapur thirrja për aplikim për pagesa direkte – subvencione 2025.

Ka përfunduar procesi i vaksinimit dhe i kontrollit të bagëtive nëpër ferma nga veterinari i angazhuar nga DBPZh-ja dhe në bazë të raportit final janë vaksinuar 7,855 dele dhe 2,353 lopë.

### **Projektet e investimeve kapitale**

Kanali i kullimit të tokave bujqësore Fortesë-Celinë - Faza e dytë;

Kanali i kullimit nga Shtavica deri në Fortesë;

Kanali i kullimit në Çifllak;

Rrugët fushore;

Ndërtimi i urave;

Ndërtimi i serrave.

## **Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Sektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	480	13,000€
Gjeodezi	230	10,360€
Referenti:	2010+27 (L.Z.)	6,010€
Totali:	<b>2,720+27 (L.Z.)</b>	<b>29,370.00€</b>

- Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim të pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim të paluajtshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj.;
- Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;
- Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte, si: koordinata, modifikime etj.;
- Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes të përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;
- Kemi mbajtur takime të rregullta me Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Sipas legjislacionit në fuqi, kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t'i japim me qira brenda vitit 2025;
- Ka vazhduar procesi i digitalizimit kadastral;
- Ka filluar procesi i rindërtimit kadastral në dy zona kadastrale në Fortesë dhe në Ratkoc.

### **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

Është bërë nënshkrimi i kontratave me 29 OJQ përfituese nga subvencionet, vlera totale e subvencioneve: **223,800.00 euro**.

Organizimi i aktiviteteve për “Javën e dëshmorëve” dhe organizime të ndryshme kulturore e artistike gjatë gjithë vitit;

Festivali i folklorit “Anadrinia jehon”

**Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi” – RAHOVEC** - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare; Klasifikimi dhe katalogimi i librit

**Në palestrën sportive “Mizahir Isma”** janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klubet e komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar, në hendboll, në futsal, në futboll etj. Zhvillimi i garave në pin-pong.

### **Drejtoria për Punë Inspektuese**

#### **1. Sektori i Ndërtimit**

- Janë kryer **77 inspektime dhe riinspektime** në terren; Janë shqiptuar **33 gjoba mandatore** për ndërtim pa leje; **15 subjekte** janë pajisur me leje ndërtimore, ndërsa **57** kanë aplikuar për kushte ndërtimore.

#### **2. Sektori i Mjedisit**

- Janë realizuar kontolle të rregullta nga inspektori i mjedisit; Janë shqiptuar **48 gjoba mandatore** për ndotje të mjedisit; Janë inspektyuar **17 biznese** që ushtrojnë veprimtari të ndjeshme për mjedisin.

## RISI E KËSAJ PERIUDHE:

Pas themelimit të fondit për shpërblim të raportimeve qytetare për ndotje, është regjistruar rritje e ndjeshme e numrit të raportimeve për raste të ndotjes mjedisore. Kjo nismë ka përmirësuar efikasitetin e sektorit dhe ka fuqizuar rolin aktiv të qytetarëve në ruajtjen e mjedisit të pastër dhe të shëndetshëm.

### 3. Sektori i Çështjeve Komunale

- Janë shqiptuar **14 gjoba** për shkelje të rregullave për përdorimin e hapësirave publike; Janë lëshuar **29 aktvendime kundrejt KRU “Gjakova”** për garantimin e zhvillimit të ligjshëm të aktiviteteve të saj; **51 shfrytëzues** të hapësirave publike janë urdhëruar të pajisen me leje të rregullta.

### 4. Sektori i Tregut

- Janë shqiptuar **2 gjoba mandatore** për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje në çmime; Janë **verifikuar peshoret** në tregjet e bukës për saktësi të matjeve; **33 biznese të reja janë regjistruar** në ARBK pas ndërhyrjes së inspektoratit.

### 5. Sektori i Transportit Publik dhe i Komunikacionit

Ky sektor ka mbikëqyrur shërbimet e transportit publik me fokus në sigurinë dhe rregullsinë.

#### STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	33	10,300.00€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUNALE	14	1800€
GJOBA MANDATORE - TREGU	2	1000€
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	49	4980€
<b>TOTALI:</b>	<b>98</b>	<b>18, 080.00€</b>

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	10	100 €
PËLQIME PUNE	33	495€
<b>TOTALI:</b>	<b>43</b>	<b>595 €</b>

<b>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI:</b>	<b>JANAR – MAJ 2025</b>	<b>18,675.00€</b>
-----------------------------------	-------------------------	-------------------

## Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Janë inspektuar lumenjtë, përroskat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e komunës; Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve;

Janë hartuar dy dokumente të rëndësishme: -Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt korrik dhe gusht; -Dokumenti për ngritjen e gatishmërisë emergjente për muajt korrik dhe gusht;

Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit, gjithsej 558 aparate;

Ekipi i zjarrfikësve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, ka marrë gjithsej 109 kërkesa për intervenime - 57 ishin kërkesa për intervenime në raste zjarri, 7 aksidente rrugore.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. e tjera janar-dhjetor 2025														
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshi me rejsh	Të	Të lënduar			Të vdekur			Githsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
janar	25	14	2	6	2	0	1	0	2	2	0	0	0	25
shkurt	14	10	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14
mars	33	24	1	8	1	1	0	0	0	0	0	1	1	33
prill	16	5	1	8	0	1	1	0	0	0	0	0	0	16
maj	21	2	5	10	4	0	0	0	0	0	0	0	0	21

## PËRFUNDIM

Ky raport përbledhës paraqet theksat kryesorë të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënieve dhe performancës sa më të mirë komunale dhe u dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që, përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Programi qeverisës dhe vizioni ynë për Rahovecin, me të gjithë së bashku, hap pas hapi, po jetësohet.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi vullnetin, gatishmërinë dhe energjinë e duhur, të jemi në dispozicion të qytetarëve, ashtu që Komuna e Rahovecit të përjetohet se është shtëpia e tyre dhe ofron të gjitha shërbimet e nevojshme për ta.

Jemi të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, për të krijuar kushte sa më të mira dhe lehtësira për: zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë.

Gjithnjë do të angazho hemi të punojmë për të mirën e përgjithshme, pa dallim.

Ju faleminderit!

Rahovec, qershori 2025

Smajl Latifi  
Kryetar i Komunës

